



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	243/15
Nr. i fq. / Br. st	- 9 -
Data: / Datum	30. 11. 2015
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCES VERBAL
NGA MBLEDHJA E IX-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,
MBAJTUR MË 29 TETOR 2015**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkyetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –njoftoi kuvendin, se anëtar i kuvendit Ermal Lahu ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të kuvendit dhe lidhur me këtë pritet vendimi i KQZ-së për zëvendësimin e tij. Tutej shtoi se pika e gjashtë e rendit të ditës informatë për subvencionet është kërkuar nga Komitetit për Politikë dhe Financa dhe e njëjtë nuk është ofruar nga ana e drejtorisë, andaj kërkoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, kurse pasi ka qenë propozim edhe në KPF, në vend të kësaj pike të futet propozim-vendimi për formimin e komisionit për verifikimin e shpërndarjes së subvencioneve. Në arsyetimin e mos ofrimit të kësaj informate nga ana e Drejtorisë për Ekonomi ceku se gjatë kualifikimit të përfituesve të këtyre subvencioneve (lopëve) ka pasur manipulime dhe pikërisht për këtë arsy është shtyrë ofrimi i informatës në fjalë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –duke ju referuar mediave ku është shprehur dyshimi se a do të përfundoj projekti i rregullimit të ujësjellësit në komunën tonë përkatësisht në fshatrat e komunës ku në rastin konkret kemi pasur një donacion për këtë pyeti se ky projekt a do të ketë shtyrje në realizimin e tij. Pastaj shtroj si çështje me mjaft rëndësi çështjen e faljes së borxheve ku pyet se sa është shuma e tyre cilat janë subjektet struktura e tyre dhe për të gjitha këto pyetej kërkoi informatë me shkrim. Tutje shtoi se çështja e autostradës Vushtrri-Prishtinë sipas të gjitha parametrave do të prolongohet, andaj kërkoi nga organet komunale që të informohen nga autoritetet qendrore dhe në mbledhjen e ardhshme të informohet kuvendi.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit –shprehu pakënaqësinë e saj lidhur me mos ofrimin e informatës për subvencionet e cila është kërkuar nga ana e Komitetit për Politikë dhe Financa, ku nga Drejtoria e Ekonomisë është kërkuar lista e aplikuesve, dhe përfituesve të subvencioneve në bujqësi, andaj konform këtyre propozoi që të formohet një komision nga kuvendi i cili do të merrej me shpërndarjen e këtyre subvencioneve (lopëve). Në fund ajo arsyetoi se komisioni i cili është formuar nga ana e ekzekutivit komunale është jo profesional ku njëri nga anëtarët e tij është praktikant. Në fund ajo propozoi që të formohet një komision kuvendar për mbikëqyrjen e shpërndarjes së subvencioneve në Komunës e Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –parashtroi dy pika shtesë të rendit të ditës draft-rregulloren për tarifa dhe ngarkesa komunale, për faktin se vendimi për heqjen e taksës në firmë është i paligjshëm pasi që çdo rregullore ndryshohet me draft-rregullore ku në këtë rast nuk ka ndodhur një gjë e tillë. Pastaj propozoi që pika në të ndryshme lidhur propozim-vendim për ridestinimin e mjeteve të komunës të bashkëngjitet pikës petë të rendit të ditës.

Bedri Dobra, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër- propozoi në të ndryshme një informatë të hartuar nga komisioni i kuvendit lidhur me lokacionin e varrezave në fshatin Stroc. **Ergyn Sunguri, anëtar i kuvendit** – propozoi që në të ndryshme të futet propozimi për diskutimin lidhur me vendimi e kuvendit për vendosjen e një “çeshmje” në sheshin e qytetit, ai me këtë rast njoftoi kuvendin se pas konsultimeve që ka pasur me zyrtaret e Drejtorisë për Urbanizëm janë ardhur në përfundim që lokacioni për vendosjen e kësaj “qeshmje” të ndryshohet, dhe kjo të vendoset në vendin e quajtur tek “hamami”.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se vendimi për vendosjen e kësaj qeshmje në sheshin e qytetit është marr nga ana e kuvendit, dhe tani nuk ka arsy që kuvendi të kthej mbrapsht vendimet e tij, dhe i njëjti nuk është zbatuar nga ana e drejtorisë kompetente. Pastaj shtoi se në këtë rast donatori nuk është treguar serioz, dhe kërkoi që për seancën e ardhshme të sillet propozim për anulimin e atij vendimi.

Në përfundim të diskutimeve rrëth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime ”aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe realizimin e investimeve kapitale;
3. Shqyrtimi i informatës lidhur me nivelin e pastërtisë së qytetit dhe eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave;
4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor i Komitetit Këshillëdhënës për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike (Shtator 2014- 2015);
5. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ridestinimin dhe transferin e mjeteve buxhetore të Komunës;
6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit lidhur me formimin e komisionit për verifikimin e shpërndarjen së subvencioneve (lopëve) në Komunën e Vushtrisë.
7. Të ndryshme.
 7. a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës 01Nr.185/15 i datës 29.09.2015.
 7. b). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.
 7. c). Shqyrtimi i Informatës nga ana e komisionit të kuvendit për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Stroc.
 7. c). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe realizimin e investimeve kapitale.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit –tha se sipas një dokumenti të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), komuna e Vushtrrisë figuron në listën e shpenzuesve ‘luksozë’, bazuar në pasqyrat financiare për vitin 2014. Auditori ka bërë të ditur se në tërë totalin e shpenzimeve për reprezentacion përkatësisht dreka zyrtare, Vushtrria zënë vendin e katërt për harxhimet më të larta në Kosovë. Ne sot, kur shikojmë shpenzimet e vitiit 2015, dhe i krahasojmë ato me të njëjtën periudhë të vitiit 2014 e shohim që shpenzimet prapë janë të larta dhe deri në fund të vitiit do të sillen në nivelet e njëjta, kjo do të thotë që prapë do të jemi në maje të listës, si një ndër komunat me shpenzimet më të larta. Hiq më mirë nuk paraqitet gjendja në disa kategori të tjera të shpenzimeve, ku shpenzimet për energji elektrike dhe ujë kanë pësuar rritje të madhe. Duke e pas parasysh gjendjen në të cilën gjenden qytetarët tanë, këto shpenzime në këtë masë janë të papranueshme dhe duhet të ulën urgjentisht. Pra ju ftoj publikisht që të keni kujdes më të madh në shpenzimin e parasë publike, mundohuni që dreakat e darkat me para të qytetarëve të i evitonit nganjëherë, kjo do të sillte te mira për qytetarët pasi ato para do të mund të shpenzoheshin për projekte të nevojshme për ta, por edhe të mira për shëndetin tuaj.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - tha se komenti tek tabela e të hyrave është vetëm një përshkrim i thjesht i numrave nga tabela. Siç dihet esenca e çdo raportimi është metoda e krahasimit ,së pari krahasimi i të hyrave të planifikuar me ato të realizuara e pastaj krahasimi me periudhën e njëjtë të vitiit të kaluar. Meqenëse shumica e delegatëve nuk janë ekonomistë dhe nuk i kuptojnë lehtë gjithë këto shifra atëherë ka qenë dashtë që te komenti i tabelave të bëhet një koment më i thjeshtë dhe më analistik që të shihet saktë se si i kemi punët me të hyrat në krahasim me vitin e kaluar. Cilësia e çdo raportimi edhe sipas auditorëve është shpjegimi sa më i thjeshtë që të kuptohet nga auditoriumi. Shpjegimi edhe më skandaloz është tek tabela e shpenzimeve apo ndoshta është bërë me qëllim të fshihen disa të dhëna ku kemi rritje të shpenzimeve në disa kategori ekonomike që është dashtë të bëhen kursime më të mëdha p.sh kemi rritje të shpenzimeve te pagat dhe mëditjet mallrat, dhe shërbimet dhe komunalit ,kurse kemi rënie te kategoritë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik si: subvencionet dhe investimet kapitale gjithnjë duke e krahasuar me periudhën e njëjtë të vitiit të kaluar. Pastaj kur krahasojmë tabelën 5 me tabelën 11 brengosës është fakti sidomos te investimet kapitale ku kemi afér 1,300.000.00 € më pak se sa ne vitin e kaluar në të njëjtën periudhë. Në këtë vit që qeveria qendrore e ka shpallur si vit i kursimeve sidomos përmallra dhe shërbime dhe komunali komuna jonë ka bërë më shumë shpenzime se vitin e kaluar pikërisht në këto kategori. Te shpenzimet sipas kodeve ekonomike kemi vërejtje te kodi 13460 shërbimet kontraktuese ku kemi rritje të shpenzimeve 100% në krahasim me vitin e kaluar kjo, ka ndodh për shkak se komuna po i mban disa punëtor me kontratë mbi vepër në mënyre kundër ligjore kur dihet se kontrata mbi vepër vlen vetëm për kuadro deficitar që nuk i ka komuna e jo përpunë që minden me i me i krye punëtorët e komunës e që fatkeqësisht disa nuk punojnë asgjë. Ne këtu kemi një tabelë të shpenzimeve të mëditjejashtë vendit që po ashtu është dyfish më shumë se vitin e kaluar dhe shtrohet pyetje cili ka qenë interes i komunës që kemi një rritje dyfish të mëditjeve. Gjithashtu tha se kemi rritje të shpenzimeve edhe te kode ekonomike si: Shpenzimet e telefonisë mobile telefonisë fikse, shërbimet teknike , kompjuterët pajisjet tjera etj. Në fund ajo në emër të grupit kuvendar të LDK-së kërkoi informatë me shkrim lidhur me regjistrimin dhe ri regjistrimin e tokave bujqësore të dhëna me qira, si dhe mjetet e grumbulluar nga këto prona, si dhe të jepen shifra se sa përfiton komuna nga dhënia e objekteve me qira.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se sa i përket mëditjeve jashtë vendit, kuvendi disa herë ka kërkua të ketë të dhëna dhe qasje në zyrtare në këto shpenzime, dhe tani po del si fakt shqetësuese që mëditjet me të shumta i kanë marrë anëtaret e kuvendit (grupi i grave delegate), dhe akoma më shqetësuese është fakti se asnjëherë nuk kemi pas një raport lidhur me shpenzimin e këtyre mjeteve (cili ka qenë qëllimi i vizitave, takimi dhe rezultatet e arritura nga këto vizita)

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-pasi përgëzoi drejtorin, dhe ZKK-në për raportin e ofruar konform kërkesave të kuvendit, edhe përkundër pyetjes dhe përgjigjes siç tha ai të

“njëanshme” të zyrës ligjore të Ministrisë së Financave raporti ka ardhur konform kërkesave të tyre për periudhën korrik-shtator 2015. Tutje shtoi se ky raport duhet edhe me tej të jetë më i plotësuar dhe më preciz duke përfshirë jo vetëm tabelat por edhe grafikonet diagramet dhe të gjitha elementet e nevojshme që të jetë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe i lehë për tu kuptuar nga ana e anëtarëve të kuvendit. Pastaj lidhur me raportimin e mëditjeve jashtë vendit dhe shpenzimeve në vlerën prej 13,018.0.80€, vlerësoi se debati duhet të fokusohet jo në vlerën e shifrave por në rezultatet e arritura nga këto vizita, andaj në këtë sferë kërkoi të bëhet një analizë dhe në kuvend të ofrohet një raport detal lidhur me këtë çështje.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se një çështje e duhet të analizohet është realizimi i investimeve kapitale në qoftë se në gjashtë mujorin e parë kemi pasur 12% realizimin tani kemi vetë 40%, dhe kjo kërkon një mobilizim të përgjithshëm që të kemi një efektivitet në realizimin e buxhetit pasi gjendemi kah fundi i vitit kalendarik. Tutje shtoi se në raport nuk figuron çështja e borxheve që ka komuna sipas viteve andaj ekzekutivi komunal ka për obligim që të informoj për këto çështje se ku dhe sa këto borxhe po falen. Pastaj kur flitet për tatimin në pronën e paluajtshme mund të themi se ai do të jetë burimi kryesor dhe i përhershëm i zhvillimit të komunës për këtë çështje kërkoi nga drejtoria të përgatitë informatë me shkrim për përqindjet e pagesës të tatimit në pronë sipas vendbanimeve me qëllim që të dimë se kush po paguan e kush jo dhe në këtë forma edhe investimit ti orientojmë konform këtyre pagesave dhe që këto para vërtet ti kthehen qytetarëve të cilët i kryejnë obligimet ndaj komunës dhe shtetit, dhe kështu të ndikohet në përmirësimin e jetesës së këtyre qytetarëve në ndërtimin e projekteve infrastrukturore. Mandej ai shprehu brengen e tij se disa herë kuvendi ka aprovuar vendimi për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim po inkasimi i mjeteve në këtë relacion është zero, këto organet komunale duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për inksimin e atyre mjeteve. Tutje duke ju referuar relacionit të komunikimit mes kuvendit dhe ekzekutivit komunal ceku se ky raport duhet të ngritët mes kryetarit të komunës përkatësisht drejtorit të drejtorisë dhe kuvendit të komunës e jo mes kuvendit dhe administratorëve referentëve komunal, lidhur me këtë çështje ceku se materiale anëtarëve anëtarëve të kuvendit iu dërgohen nga ana e këtyre referentëve e jo nga zyrtaret komunal. Pastaj ceku se në raport mungon komperacioni i vlerësimeve me periudhat e kaluara në përqindje dhe kjo është mirë që të futet në këtë raport. Në vazhdim ai duke ju referuar raportit ceku se ka dilemë lidhur me shumën e mjeteve financiare në vlerën prej 409,890.34€ të përcaktuara në kodin *shërbime kontraktuese tjera* pyeti se për çfarë bëhet fjalë? Kurse vlerat tjera simbolike futen në raport dhe arsyetohen andaj lidhur me këtë kod ekonomik kërkoi që të zbërthehet. Një çështje tjetër e cila është interesante që të analizohet është se në këtë periudhë raportuese kemi rritej të shpenzimeve për energji elektrike dhe atë nëse për vitin 2014 kemi 92,762.00€ për vitin 2015 deri në këtë periudhë kemi 130,490.46€ dhe në këtë rast duhet të dimë se a kemi rritej të çmimit të rrymës apo kemi me rritej të shpenzimeve të energjisë elektrike që në këtë rast është marramendës andaj konform këtyre vërejtjeve dhe sugjerimeve duhet të bëhet një analizë e mirëfilltë me qëllim që të kemi një shpenzim racional të parasë publike.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se anëtaret e kuvendit duhet të bëjnë ndarjen mes informatës, raportit, analizës dhe krahasimit të hyrave dhe shpenzimeve komunale. Pastaj ri përsërit propozimin e tij për formimin e një komisioni mikst mes kuvendit dhe Drejtorisë së Financave për hartimin e një forme unike të raportit për shpenzimet komunale. Në vazhdim ai dha përgjigje në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

3. Shqyrtimi i informatës lidhur me nivelin e pastërtisë së qytetit dhe eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se vazhdimi këtë kanë kërkuar që të përmirësohet gjendja e pastërtisë në Komunën tonë. Tutje shtoi se e kanë përkrahur çdo iniciativë të komunës të ndërmarrë për këtë çështje, kemi kundërshtuar politikat e ndërmarrjes rajonale e cila aktualisht merret me menaxhimin e mbeturinave, kemi ngritur shqetësimin tonë për mos

pagesën e rregullt të pagave nga kjo kompani për punëtoret e saj, dhe shumë probleme që edhe sot janë evidente. Pra, mund të konludojmë që qyteti ynë deri sot nuk ka shënuar as më të voglin përparim në këtë fushë dhe kjo është e pa justifikueshme Por, ajo e cila më së shumti më ka indinjuar është mos marrja parasysh e ankesës time të bërë në emër të Arif Zekes, babait të dy martirëve, i cili e ka ngritur shqetësimin e tij në lidhje me mos përkujdesjen ndaj varrezave të Martirëve që gjenden afér varrezave të vjetra të qytetit në Vushtrri ku, afér këtyre varrezave gjenden edhe dy kontejnerë të mëdhenj të mbeturinave përfajin e të cilëve, në afërsi të varrezave është krijuar një deponi e madhe e mbeturinave e cila e degradon edhe vet imazhin e varrezave të Martirëve. Njoftoi se kishte kërkuar që urgjentisht të zhvendosen ata kontejnerë të mbeturinave nga ai vend, por asgjë nuk ka ndodhur deri më tani. Andaj prapë e shfrytëzoj rastin të kërkoj që të hiqen këta kontejner nga aty dhe atyre varrezave t'u jepet respekti i merituar. Shpresoj që së paku kjo çështje konkrete, e këtyre kontejnerëve do të zgjidhet e nuk do të më duhet të përsëritëm më këtu në këtë folto.

Argon Përçuku, anëtar i kuvendit- tha se pavarësisht informatës nga ana e Drejtorisë për Shërbimeve Publike lidhur me eliminimin e deponive ilegale te mbeturinave Në rrugën "Jeton Terstena" në Vushtrri e cila është mjafte e frekuentueshme si nga qytetaret ashtu edhe nga nxënësit e dy shkollave në këtë pjese të ashtuquajtur afér "Barakave" është duke u hedhur mbeturina të cilat çdo dite e më shumë po rritet dhe po kundërmjnë jashtëzakonisht shumë ,të cilat po ndikojnë në keqësimin e shëndetit të njeriut, po ashtu si rrezik i cili mund ti kanoset secilit qytetar që parakalon andej (për shkak te pranisë të qeneve endacak). Kërkoj nga organet kompetente eliminimin e këtyre mbeturinave në atë pjese dhe vendosjen e mekanizmave të posaçëm në mënyrë që mos të vazhdoj hedhja e mbeturinave më tutje.

Pastaj shtoi se në rrugën "Marin Barleti" në Vushtrri është shembur një shtëpi dhe e ka bllokuar rrugën, shtëpia është pronë e një qytetarit romë ,ku fal zotit në atë moment nuk ka hasur në ndonjë qytetare edhe pse ajo pjese është bërë mjaft e frekuentume për automjete dhe qytetar për shkak të parkingjeve të automjeteve që ndodhura në atë pjese. Po ashtu ajo shtëpi edhe pse tani gjysmë e rreuan paraqet një rrezik për banoret dhe kalimtaret e rastit për arsyen ende mund të shembet. Gjithashu shtëpia në fjale ka një javë që është rrëzuar dhe ka bllokuar rrugën. Andaj kërkoj nga organet kompetente të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për krijimin e parakushteve për kalimin e automjeteve dhe sigurimin e qytetarit nga rreziku potencial nga ajo shtëpi.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-tha se nuk dyshon se DSHP-ja ka qenë e përkushtuar në krijimin e kushteve të nevojshme për krijimin e një ambienti të pastër por, me gjithë atë pastërtia në qytetin tonë nuk është në nivelin e kënaqshëm. Tutje ajo parashtroj disa vërejtje në adresë të drejtorisë kompetente ku gjatë stinës së verës shportat në sheshin e qytetit nuk kanë qenë të zbrazëta si duhet dhe ato kanë kundërmua erë shumë të keqe. Pastaj shtoi se tabelat e emërtimeve të rrugëve në shumë raste janë dëmtuar dhe për këtë çështje askush nuk kujdeset në mirëmbajtjen e tyre. Mandjej në shëtitoren e qytetit tek lumi "Sitnica" është duke u shkaktuar një ndotje shumë e madhe nga thertorja që kryen veprimitarin atje. Lidhur me mirëmbajtjen e shtratit të lumbit "Tërrstena" kërkoj nga kompetentet që ndërmerr masa për mirëmbajtjen e tij, kurse lidhur me trajtimin e qenve endacak kërkoj të merren veprimet e nevojshme. Në fund tha se është mirë që të shikohet mundësia që Kompania Regionale "Uniteti" të pjesa e aksioneve të komunës sonë të shndërrrohet në asete me pronësi komunale në këtë relacion tha se shpreson që Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave si dhe plani të ndikojnë në krijimin e kushteve për një mjedis sa më të pastër.

Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit-kërkoj që në rrugën "Bahri Kuqi" në kryqëzimin tek shkolla fillore "Çajupi" të hiqen kontejnerët që gjenden afér furrës së bukës e të cilët paraqesin rrezik për nxënësit dhe për banoret që gjenden për rrëth saj.

4. Shqyrimi i Raportit Vjetor i Komitetit Këshillëdhënës për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike (Shtator 2014- 2015).

5.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ridestinimin dhe transferin e mjeteve buxhetore të Komunës.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – tha se këtu kemi një kërkesë e fatkeqësishë edhe një propozim vendim të kryesuesit të bazuar në atë kërkesë që është hartuar në mënyrë shumë jo profesionale dhe të pa qartë.

Tutje shtoi se nëse lexohet me vëmendje kjo kërkesë mund të bindeni se në çfarë mënyre jo profesionale është hartuar .

Këtu shtrohet pyetja për çka është bërë planifikimi i buxhetit e pastaj edhe rebalanci e tash dy muaj para fundit të vitit fiskal kërkohen edhe 15,000.00 € për komunal ,apo edhe këtu kemi rritje aq të madhe të komunalive.

Edhe më skandaloze është tabela 4.2 ku të dhënat në tabelë nuk korrespondojnë me arsyetimin e drejtorit dhe propozimin e kryesuesit për ridestinimin e mjeteve për investime kapitale në shumë prej 38,037.00 € .

Pra nga tabela 4.2 kemi dy shuma 28,537.00€ dhe 3,500.00€ që në total bëjnë 32,037.00 € për ridestinim e jo 38,037.00€ siç është kërkuar në arsyetim dhe propozim vendim Këtu shihet se shumën prej 6,000.00 € është llogaritur dy herë nga ana e drejtorit.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke dhënë përgjigje për anëtarëve të kuvendit.

Isa Haxhiu, anëtar i kuvendit- pyeti se shuma e mjeteve prej 9.500€ të dedikuara për shkollën SH.M.U 2 janë të destinuara për rregullimin e tërësisë hënë të ngrohjes qendrore apo vetëm riparimit të saj.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 27 vota “për”, 1 votë “kundër” tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë Vendim bëhet transferi i mjeteve nga fondi burimor 10 (investime kapitale) në shumë prej 6000€, fondi burimor 21 (investime kapitale) në shumë prej 6000€ si dhe nga fondi burimor 22 (investime kapitale) në shumë prej 3500€.

2. Nga fondi burimor 10 (investime kapitale) bëhet ridestinimi i mjeteve në shumë prej 27,625€, nga fondi burimor 21 (investime kapitale) në shumë prej 3570€

3. Mjetet e transferuara dhe ridestinuara sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi bëhen sipas tabelës 4.2.

4. Nga kategoria “mallra dhe shërbime” transferohet shuma prej 15000€ në kategorinë “shpenzimet komunale”

5. Mjetet e transferuara sipas pikës 4 të këtij vendimi bëhen sipas tabelës 4.1.

6. Pjesë përbërës e këtij vendimi janë tabelat 4.1 dhe 4.2.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe i njëjti i dërgohet Ministrisë së Financave.

6.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit lidhur me formimin e komisionit për verifikimin e shpërndarjen së subvencioneve (lopëve) në Komunën e Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –propozoi çelësin e përbërjes së Komisionit për Verifikimin e Shpërndarjes së Subvencioneve (lopëve) në Komunën e Vushtrrisë, dhe atë me sa vijon: dy anëtar nga radhët e PDK-së, një nga LDK-ja, një nga VV-ja dhe një nga AAK-ja. **Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** –shprehu pakënaqësinë e tij lidhur me përbërjen e komisionit në fjalë për faktin se shumica e anëtarëve të kuvendit nga radhët e AAK-së kanë kaluar në PDK, dhe tani ata po barazohen me subjektin e LDK-së në komisione kuvendare gjë e cila sipas tij është e pa drejt. Në fund për anëtar të komisionit të lart cekur propozoi Agron Perçukun.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me 18 vota “për” 10 vota “kundër” tjerat “abstenim” aprovoi çelësin e formimit të Komisionit për verifikimin e Shpërndarjes së Subvencioneve (lopëve) në Komunën e Vushtrrisë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi Ilmi Azemin dhe Safet Osmanin për anëtar të komisionit në fjalë.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi Agron Perçukun për anëtar të komisionit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të VV-së propozoi Mehmet Selacin për anëtar të këtij komisioni.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –propozoi Rrahim Ajetin për anëtar të komisionit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 30 vota “për” 1 votë “kundër” të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni komunal për verifikimin e gjendjes lidhur me shpërndarjen e subvencioneve në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:

- 1.1 Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.2 Safet Osman, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.3 Agron Perçuku, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.4 Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit (LVV); dhe
- 1.5 Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit (AAK);

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

7.Të ndryshme.

7. a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës 01Nr.185/15 i datës 29.09.2015.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01Nr.185/15 i datës 29.09.2015, lidhur me heqjen e taksës në firmë për subjektet afariste të cilat e ushtrojnë veprimtarin e tyre në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Sekretaria e Kuvendit.

b). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanim vendosi me sa vijon:

- 1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.
- 2.Diskutimi publik fillon nga data 03 nëntor 2015 dhe zgjatë deri më 20 nëntor 2015.
- 3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
- 4.Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
- Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin nëntor 2015.

c). Shqyrtimi i Informatës nga ana e komisionit të kuvendit për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Stroc.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit –njoftoi kuvendin për punë e bërë nga ana e komisionit për verifikimin e gjendjes faktike të caktimit të lokacionit për varrezat e fshatit Stroc. Tutja ai shtoi se pas një peticioni të ushtruar nga ana e banorëve të fshatit Gllavatin për kundërshtimin e vendimit të kuvendit lidhur me këtë çështje, kuvendi në muajin korrik ka formuar këtë komision me qëllim të gjetjes së një zgjidhje të pranueshme për të gjithë. Pastaj ai vazhdoi duke vlerësuar se pas vizitave që komision ka realizuar në muajin shtator të lokacionit të ndarë për nga ana e kuvendit, mandej komisioni ka vizituar edhe lokacione tjera të cila janë propozuar nga banoret e këtyre lokaliteteve për vendosjen e varrezave. Andaj në pajtim me përfaqësuesit e këtyre banorëve komision ka marrë vendim me sa vijon: *të bëhet zhvendosja e lokacionit të ndarë për varreza në afërsi të rrugës në anën perëndimore në largësi prej 200 metrave, lokacioni i ndarë me të njëjtën sipërfaqe por me obligimin e marr nga ana e komunës që të bëhet rregullimi (shtrimi i rrugës e rendit të IV), deri në vendi e caktuar për vendosjen e varrezave.*

Pas informimit të kuvendit nga ana e kryetarit të komisionit të kuvendit për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Stroc, komisioni i propozon kuvendit me sa vijon:
Që në të njëjtën parcelë të ndarë më herët për vendosjen e varrezave të fshatit Stroc të bëhet zhvendosja e lokacionit të varrezave në largësi prej 200 metrave në anë perëndimore dhe me këtë duhet që të bëhet ndryshmi i vendimit të mëhershëm për këtë çështje.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –njoftoi kuvendin për një vizitë pune që kuvendi i komunës do ta realizoj në Shqipëri ku kërkoj që anëtarët e kuvendit të konfirmojnë prezencën e tyre si dhe nga drejtorit komunal kërkoj që në zyrën e kuvendit të dërgohen temat (pikat e rendit të ditës) që do të futen në Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2015.

7. c). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit –paraqiti një shqetësim i cili shprehu se nuk është vetëm i tij por është i të gjithë qytetarëve. Pastaj ceku se jo shumë muaj më parë ka tërhequr vërejtjen

se në komunën tonë ka rënë numri i policëve që patrullojnë, kjo sipas informatave nga vetë policët. Andaj nga kjo kishte kërkuar që kryetari të merr masa, duke u takuar më organet kompetente që ky numër i policëve dhe i patrullimeve të shtohet. Tani, ka informata që kriminaliteti në komunën tonë ka rritje të madhe, sidomos të rastet e vjedhjeve nëpër shtëpi dhe banesa. Prandaj kërkoj prapë që kryetari të takohet me personat kompetent nga organet përkatëse dhe të kërkoj nga ta që të rritet siguria në qytetin tonë. Përndryshe, frika tek qytetarët do të rritet dhe Vushtrria ngadalë po e humbë epitetin si ndër qytetet më të qeta dhe të sigurta. **Zoran Rakiç, anëtar i kuvendit** - shprehu brengen e tij se disa fshatra përgjatë auto rrugës Prishtinë-Mitrovicë siç është Stanoci i Poshtomë Prelluzha dhe disa fshatra tjera janë mbetur keq sa i përket kyçjesë në këtë rrugë për faktin se duhet bërë disa kilometra deri në fshatin Babimoc, andaj për këtë kërkoi që komuna të bëjnë ndonjë zgjidhje.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - shprehu brengen se tij me atë siç tha ai se qytetaret ankohen se disa drejtore të drejtive komunale Gani Imeri drejtore i DSHP-së, Bedri Dobra, drejtore i DGJKP-së si dhe drejtori i DSHPS-së Abdullah Klinaku nuk qëndrojnë në vendet e tyre të punës për këtë kërkoi që kryetari i komunës të ndërmarr masa konkrete ligjore. Pastaj kërkoi informatë me shkrim nga Drejtoria e Inspektive lidhur me lëndën për të cilën ai thotë se e ka dërguar në gjykatë për tejkalimin e lejes ndërtimore të ndërtesës afér Spitalit ku thuhet se është ndërtuar një kat më tepër në kundërshtim me planin urbanistik. Mandej pyeti se çfarë masash ka ndërmarrë Drejtoria e Inspektive lidhur me ndërtesën që është në ndërtim e sipër afér çerdhes së qytetit që po ashtu ka ndërtim pa leje të një kati e që po ashtu edhe ky ndërtim është bërë në kundërshtim me planin urbanistik. Për Drejtoren e Kulturës dhe kryetarin e komunës adresoi pyetje se cilat masa janë ndërmarr për rregullimin e kulmit të palestrës "Jeton Tërrstena" kur dihet se kulmi i kësaj qendre pikën sa herë që kemi të reshura. Dhe në fund pyeti se përse rruga kryesore e fshatit Sllatinë nuk është futur në projekt-buxhet për vitin 2016, përfaktin se rrugët anësore të këtij fshatit janë të asfaltuara dhe kërkoi të dijë se a janë ndërmarr masa ndaj operatorit kontraktues i cili ka bërë shtrimin e kësaj rruge me një kualitet tejet të dobët, andaj kërkoi që kjo rrugë të futet në prioritet në buxhetin final për vitin 2016.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-pyeti drejtoren e Drejtorisë së Arsimit, për realizimin e projektit të quajtur "Dhëmbë të Shëndosh Fëmijë të Lumtur" dhe shtoi se përse për këtë projekt asnjëherë nuk na është ofruar ndonjë raport përfaktin se akoma nuk e dimë se si janë shfrytëzuar ato mjete kur dihet se shumë prej atyre pakove të cilat iu janë dhënë nxënësve të njëjtat janë hedhur në rrugë si të pavlera.

Sami Istrefi, drejtore i DUMM-së-njoftoi anëtarin e kuvendit Hysni Gërgurin lidhur me çështje e dëmtimit të rrugës në fshatin Sllatinë përfaktin se akoma nuk e dimë se si janë shfrytëzuar ato mjete kur dihet se shumë prej atyre pakove të cilat iu janë dhënë nxënësve të njëjtat janë hedhur në rrugë si të pavlera.


Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit